



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Prishtinë, 23 mars 2023**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1708\_2023**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Neni 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 16, paragrafi 1.12 dhe paragrafi 1.13 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 12 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 07.12.2022 për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit pesë (5) Vjeçar Zhvillimor të Transmetimit 2023 – 2027,

**në seancën e mbajtur me datë 23 mars 2023 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

- I. APROVOHET** - Plani pesë (5) Vjeçar Zhvillimor i Transmetimit për periudhën 2023 – 2027 i KOSTT SH.A.
- II. OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, që të zbatoj projektet e planifikuara sipas këtij plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Transmetimit.

## **A r s y e t i m**

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 07.12.2022 ka pranuar kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Planit pesë (5) Vjeçar Zhvillimor të Transmetimit për periudhën 2023 – 2027 të KOSTT SH.A.
- o ZRRE ka analizuar dokumentin, dhe ka konstatuar se i njëjti është harmonizuar me Planin dhjetë (10) vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit, dokumentacionin e planifikimit hapësinor, Planin Zhvillimor të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, dhe ka konstatuar se janë në pajtim me kërkesat ligjore.



- o ZRRE pas vlerësimit të Planit Zhvillimor të njëjtin e ka hapur për diskutim publik për të pranuar komete sugjerime dhe vlerësime si nga të licencuarat po ashtu edhe nga palët e interesit.
- o Pas përfundimit të konsultimit publik, dhe pas takimeve të shumta mes ZRRE, KOSTT dhe KEDS rreth harmonizimit të planeve, KOSTT SH.A. më datë 02.03.2023 ka dërguar në ZRRE për shqyrtim dhe aprovim të Planit 5 Vjeçar Zhvillimor të Transmetimit 2023 – 2027.
- o Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit 5 Vjeçar Zhvillimor të Transmetimit 2023 – 2027 ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Shtojcë: Plani pesë (5) Vjeçar Zhvillimor i Transmetimit 2023 – 2027.**

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
Lutfije Dervishi, anëtar

  
Gani Buçaj, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të ZRRE-së.